

**“Eksplorimi i pasojave psikologjike të kontrollit të ish- sigurimit, përmes mekanizmit të infiltrimit gjatë periudhës së regjimit komunist te individit, familja dhe fëmijët, parë nga sytë e brezit pasardhës të grupmohës 20-25 vjeç”.**

**Kadrije Tabaku & Evita Karanxha**

## **Bio**

**Kadrije Tabaku** Psikologe Nisma Arsis. Përgjegjësitë kryesore të këtij pozicioni përfshijnë ofrimin e një mjedisi të sigurt fizik dhe emocional, asistim në plotësimin e nevojave, ofrim këshillimi, vlerësimin e nevojave të përfituesve. 20 Mars 2025 – aktualisht Koordinatore Projektsh Eugenius Foundation Ky pozicion vullnetar konsiston në kryerjen e një sërë detyrash të lidhura me planifikimin, organizimin dhe ndjekjen e iniciativave të fondacionit. Prill 2025 – Aktualisht mbështetëse e Shërbimeve të kujdesit social në bashkinë Kamëz World Vision Albania. Kjo eksperiencë si pjesë e programit “BE për kujdesin social” konsiston në vendosjen si vullnetare në mbështetje të shërbimeve sociale, përmes bashkëndarjes së punëve në funksion të shpërndarjes së ngarkesës të punonjësve socialë.

**Evita Karanxha** Psikologe me orientim klinik. E angazhuar në kërkime shkencore dhe projekte mbi shëndetin mendor, me fokus te përjetimet emocionale, somatizimi, marrëdhëniet ndërpersonale dhe përvojën njerëzore përtej simptomave.

## **ABSTRAKT**

Në një kohë kur vetmia është ulur në mesin e shoqërisë ky studim synon të hulumtojë rolin e mekanizmit të infiltrimit në këtë fenomen përmes eksplorimit të pasojave psikologjike të përdorimit të tij.

Kërkimi ka ndjekur dizajnin e një studimi cilësor. U zhvillua një intervistë e hapur me pyetje të bazuara në “Historical Intergenerational Trauma Questionnaire” dhe “Danieli Inventory of Multigenerational Legacies of Trauma”. Ajo përqëndrohet në narrativat prindërore mbi kohën e komunizmit, marrëdhënien e familjes me botën, stilet e komunikimit në familje dhe besimet e pasardhësve për botën. Në total janë zhvilluar 5 intervista me një kampion konvenience të përbërë nga të rinj të grupmohës 20-25 vjeç të të dy seksëve. Kriter përjashtues ishte mosha e prindërve. Pikëpamjet për botën kanë karakter dinamik por duke qenë se në periudhën e adoleshencës individit fillon të zhvendosë vëmendjen për plotësimin e nevojave atashuese drejt figurave të tjera në botë bashkangjitur dhe një zhvillimi kognitiv më të avancuar se fëmijëria, duke patur më shumë mjete

për ti dhënë kuptim çka ndodh përreth u pa e nevojshme që prindërit e kampionit të kenë qenë minimalisht mbi 16 vjeç në vitin e përfundimit të sistemit komunist. Intervistat u regjistruan, transkriptuan dhe iu nënshtruan kodimit të hapur e më pas atij aksial. Nga pjesëmarrësit u dha miratimi i informuar.

Nga të dhënat rezultoi se bisedat mbi komunizmin nxiteshin nga stimuj të përditshmërisë. Përmbajtja konsistonte në mënyrën e jetesës, krahasimin midis së tashmes dhe të shkuarës, marrëdhëniet njerëzore, internimet. Në narrativat mbi spiunimin u vu re prezenca e gjendjes së hipervigjilencës sociale dhe vetmisë emocionale. Burimet e hipervigjilencës ishin frika për të vepruar apo folur. Frika nxiste dyshimin të çdokush, shoqëruar me lidhje sociale aspak intime. Individët mbartin nga ajo kohë besimet për botën si të rrezikshme. Hipervigjilenca sociale vazhdon aktivitetin në familjet e krijuara nga ta dhe shfaqet si mosndarje informacioni, qëndrimi në gjendje performance nëpër situata sociale, pritshmëri për tu dëmtuar nga të tjerët. Në to shfaqet izolimi emocional social me shmangie ndërveprimesh sociale. Në ndërveprimin me njëri-tjetrin shfaqet konformizëm ndaj autoritetit, mungesë vulnerabiliteti e verbalizimi të afeksionit. Dëgjimi i narrativave prindërore të fëmijët të cilët nxjerrin mesazhe për të interpretuar botën ka marë pjesë në transmetimin e traumës. Hipervigjilenca sociale të fëmijët e tyre shfaqet me mungesë të intimitetit, sigurisë, besimit e vulnerabilitetit, analizimin e sjelljeve të tjetrit, ruajtjen e distancës emocionale. Ata gjithashtu e perceptojnë botën si një vend të rrezikshëm.

Përmes këtyre rezultateve përftohet një pamje më e qartë për fokusimin e punës më të rinjtë për uljen e pasojave negative psikologjike të diktaturës komuniste.

Fjalë kyçe: narrativa, trauma ndërbreznore, marrëdhënie sociale